



Komuna e Obiliqit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 02-020-01-29659-24

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg. _____

Data / Datum / Date 30.09.2024
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



Islamic Relief Kosova

Marrëveshje bashkëpunimi / Agreement

Ndërmjet / Between

Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW) / IRW Kosovo Office

dhe / and

Komuna e Obiliqit / Municipality of Obiliq

Për realizimin e projektit humanitar përmes së cilës përcaktohen kushtet mes Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) dhe Komuna e Obiliqit (Komuna) në lidhje me bashkimin e mjeteve/fondeve për projektin Mamografia dhe Mbështetje Bujqësore për Personat në Nevojë në Komunën e Obiliqit që është pjesë e projektit të IRW me pin kod numër HQ0202520101 përkrahur nga zyra e Islamic Relief Canada.

Neni 1 Qëllimi i marrëveshjes

1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është të përcaktojë formën e bashkëpunimit mes IRW dhe Komunës me qëllim të implementimit dhe finalizimit të projektit që ka për qëllim subvencionimin e fermerëve në Komunën e Obiliqit me paisje bujqësore.

1.2 Përfitues nga ky projekt do të jenë banorët e Komunës së Obiliqit.

Neni 2 Përshkrimi i projektit

2.1 Menaxhues i projektit është IRW në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

For the realization of the humanitarian project through the service of conditions between Islamic Relief Worldwide - office in Kosovo (IRW) and the Municipality of Obiliq regarding the join of funds / donations for the project Mammography & Agricultural Support for People in Need for the Municipality of Obiliq which is part of the IRW project with pin code number HQ0202520101 supported by Islamic Relief office in Canada.

Article 1 Purpose of the agreement

1.1 The purpose of this agreement is to determine the form of cooperation between IRW and the Municipality in order to implement and finalize the project that aims to support farmers in Municipality of Obiliq with agricultural equipments.

1.2 Beneficiaries of this project will be residents of the Municipality of Obiliq.

Article 2 Project description

2.1 The project is managed by IRW in cooperation with the Directorate of Agriculture, Forestry and Rural Development

2.2 Participimi i Komunës do të bëhet me anë të transferit të mjeteve të komunës në llogarinë bankare të IRW, NLB 1708200008014285, pas nënshkrimit të marrëveshjes me qëllim të startimit të punëve, për projektin dhe fondet e zotuar të parapara në projekt për vitin 2024/2026, pastaj IR do të dëshmoj faturat e shpenzimeve dhe raportit të shërbimeve të ofruara.

2.3 Procedura e selektimit të fermerëve të cilët do të jenë përfitues të këtij projekti do të organizohet nga IRW & Komuna me komision për selektimin e fermerëve në bazë të kriterëve të krijuara nga Komuna së bashku me Islamic Relief Kosova.

2.4 Monitorimin, organizimin si dhe raportimin për kuantitetin si dhe kualitetin e shërbimeve do ta bëjë koordinatori/mbikëqyrësi i projektit i cili do të jetë në bashkëpunim të rregullt me Komunën.

Neni 3 Obligimet e palëve

3.1 Participimi financiar

3.1.1 Në kuadër të projektit me pin kod HQ0202520101 IRW do të sigurojë pjesën e fondeve në vlerë prej **61,956.52€** (gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e dy cent) ose **50.80%** të vlerës totale për implementimin e këtij projekti.

3.1.2 Në kuadër të buxhetit Komunal, Komuna do të participojë me kontribut financiar në shumën prej **60,000.00€** (gjashtëdhjetë mijë euro) ose **49.20%** të vlerës totale për implementimin e këtij projekti ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.

3.1.3 Total vlera e projektit është **121,956.52€** (njëqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e dy cent), duke përfshirë fondet nga ana e Islamic Relief Kosova dhe Komuna e Obiliqit ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.

Neni 4 Përgjegjësitë e palëve

4.1 Është e kuptueshme nga të dyja palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje që çdo palë duhet të jetë e aftë për të përmbushur përgjegjësitë sipas kësaj

2.2 The municipality's participation will be made by transferring the municipality's funds to the bank account of IRW NLB 1708200008014285, after signing the agreement agreement in order to start work, for the project and the committed funds provided in the project for 2024/2026, then IR will prove the invoices of the expenses and the report of the services provided.

2.3 Procedures for selecting farmers which will be beneficiaries of this project, will be organized by the IRW & Municipality with the Commission for the Selection of farmers based on criteria established by the Municipality together with Islamic Relief Kosova.

2.4 Monitoring, organization and reporting on the quality and quality of services should be done by the project coordinator/supervisor who will be in regular cooperation with the Municipality.

Article 3 Obligations of the parties

3.1 Financial participation

3.1.1 Within the project with pin code HQ0202520101 IRW will provide part of the funds in the amount of **61,956.52€** (sixty one thousand nine hundred and fifty six euros and fifty two cents) or **50.80%** of the total value for the implementation of this project.

3.1.2 Within the Municipal budget, the Municipality will participate with a financial contribution in the amount of **60,000.00€** (sixty thousand euros) or **49.20%** of the total value for the implementation of this project as presented in Annex A of this Agreement.

3.1.3 The total value of the project is **121,956.52€** (one hundred and twenty one thousand nine hundred and fifty six euros and fifty two cents) including funds from Islamic Relief Kosovo and the Municipality of Obiliq as presented in Appendix A of this Agreement.

Article 4 Responsibilities of the parties

4.1 It is understood by both parties to this Agreement that each party must be capable of fulfilling its responsibilities under this Agreement. If at any time the municipality is unable to perform its functions under the

marrëveshjeje. Nëse në çdo kohë komuna nuk është në gjendje të kryejë funksionet e saj sipas Marrëveshjes, menjëherë do të njoftojë IRW - Koordinatorën e Programit si dhe e kundërta.

4.2 Të dyja palët bien dakord për të emëruar koordinatorët për zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje.

4.3 Koordinatorët do të jenë përgjegjës për rolet e institucionit të tyre dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

4.4 Personi kontaktues i caktuar nga Komuna pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje si dhe personi kontaktues i caktuar nga IRW pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 5 Koordinatorët

6.1 Koordinatori për IRW
Emri: Jetmira Zeka
Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, NO. 10/ A
Prishtinë, Republika e Kosovës
Zyra Telefon: 038/232-431 /
Email: jetmira.zeka@ir-rks.org

6.2 Koordinatori për Komunë
Emri:
Adresa:
Telefoni:
Tel/Fax:
Email:

Neni 6 Gjuha zyrtare e marrëveshjes

7.1 Gjuha që mbizotëron në këtë marrëveshje është versioni në Gjuhën shqipe.

Neni 8 Kohëzgjatja e marrëveshjes

8.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të Drejtorit për Kosovë të Islamic Relief Worldwide zyra në

Agreement, it shall immediately notify IRW - Program Coordinator and vice versa.

4.2 Both Parties agree to appoint coordinators for the successful implementation of this Agreement.

4.3 The Coordinators shall be responsible for the roles of their Institution and for ensuring the successful implementation of the articles of this Agreement.

4.4 The Contact Person designated by the Municipality agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement and the Contact Person designated by IRW agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement.

Article 6 Coordinators

6.1 IRW Coordinator
Name: Jetmira Zeka
Address: Bajram Kelmendi Street, NO. 10 / A
Pristina, Republic of Kosovo
Office Phone: 038/232-431 /
Email: jetmira.zeka@ir-rks.org

6.2 Coordinator for the Municipality
Name:
Address:
Phone:
Tel / Fax:
E-mail:

Article 6 Official language of the agreement

7.1 The language prevailing in this Agreement is the Albanian language version.

Article 8 Duration of the agreement

8.1 This Agreement shall enter into force upon signature of the Director for Kosovo of the Islamic Relief Worldwide office in Kosovo, and the Mayor of Obiliq, and shall continue until 30th of August, 2026 when the

Kosovë, dhe Kryetarit të Komunës së Obiliqit, dhe do të vazhdojë deri më 30 gusht 2026 kur pritet edhe të përfundojë realizimi i projektit.

**Neni 9
Mosmarrëveshjet**

9.1 Në rast të ngecjeve të realizimit të projektit palët pajtohen që të bëjnë ndryshimin e kësaj marrëveshjeje për një periudhë tjetër me aneks të ri të kësaj marrëveshjeje me shkrim dhe të nënshkruar nga të dyja palët.

implementation and monitoring of the project is expected to be completed.

**Article 9
Disputes**

9.1 In the event of project implementation delays, the Parties agree to amend this Agreement for another period with a new Annex to this Agreement in writing and signed by both parties.

Islamic Relief Worldwide – Kosovo Office




Dr. Mohamed Soliman

Country Director Islamic Relief Kosovo

Data/Date: 30-09-2024



Komuna e Obiliqit / Municipality of Obiliq



Z. Xhafer Gashi

Kryetar / Mayor

Data/Date: 30.09.2024

Bujqesi - IRW & Obilijq

Pershkrimi Description	Total IRW & Obilijq			IRW		Komuna Obilijq		IRW %	Obilijq %
	Units	Price	Total	Units	Amount	Units	Amount		
Milling machine 1.60m / Freza 1.60m	20	950.00	19,000.00	20	€ 19,000.00		€ -	100%	0%
Sprayer-Sterilizer 400-450L	20	650.00	13,000.00	20	€ 13,000.00		€ -	100%	0%
Small Motocultivator & Milling Machine	50	500.00	25,000.00	50	€ 25,000.00		€ -	100%	0%
Mikser per perzierje ushqimi 1.5	12	4,600.00	55,200.00		€ -	12	€ 55,200.00	0%	100%
Indirekt 8%			9,756.52		€ 4,956.52		€ 4,800.00	51%	49%
Total:			121,956.52		€ 61,956.52		€ 60,000.00	50.80%	49.20%